



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së katërt të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, e mbajtur më
08.06.2016, e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Halim Halimi, kryesues i Kuvendit, Shpend Ahmeti, kryetar, këshilltarët e Kuvendit: Sami Hamiti, shef i GP-së (LDK), Hazir Borovci (LDK), Agim Gashi (LDK), Shefki Gashi (LDK), Sokol Krasniqi (LDK), Shaip Hajrizi (LDK), Muhamet Nura (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Vlora Dumoshi (LDK), Hasime Krasniqi (LDK), Besa Rafuna (LDK), Naime Osmani (LDK), Shiqeri Spahiu (LDK), Flamur Shala (LDK), Ajnishahe Azemi (LDK), Qëndron Kastrati, shef i GP-së (LVV), Sylejman Pireva (LVV), Hatixhe Hoxha (LVV), Genc Sherifi (LVV), Teuta Krasniqi (LVV), Hatixhe Latifi - Pupovci (LVV), Ylli Hoxha (LVV), Kreshnik Ahmeti (LVV), Sadri Ramabaja (LVV), Lirak Çelaj, shef i GP-së (PDK), Shemsi Veseli (PDK), Shaip Shabani (PDK), Lirie Avdiu (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Laura Zherka (PDK), Mirlinda Sopi, shefe e GP-së (AKR), Sami Boroci, (AKR), Sofije Bunjaku (AKR), Remzi Pacolli (AKR), Brahim Mehmetaj, shef i GP-së (AAK-LDD), Imer Rusinovci (AAK-LDD), Rita Begolli (AAK-LDD), Fadil Gashi (AAK-LDD), Feti Mehdiu, shef i GP-së (PD), Abetare Fazliu, përfaqësuese e subjektit politik (LB), Nenad Miladinoviqi, përfaqësues i subjektit politik GIS dhe Abit Kastrati.

Munguan: Vjollca Dibra - Ibrahim (LDK), Merita Surkishi (LDK), Bardha Dida - Rogova (LVV), Blerand Stavileci (PDK), Kimet Zeqa (PD), Lirijeta Rexhepi (PDK) dhe Visar Arifaj, përfaqësues i subjektit politik PF.

Të pranishëm ishin edhe përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të KFOR-it dhe përfaqësues të OSBE-së.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Halim Halimi**, kryesues, i cili propozoi që në rend të ditës të futet edhe Plani i punës së Kuvendit të Komunës së Prishtinës për vitin 2016.

Kryesuesi hapi diskutimin për rendin e ditës.

Lidhur me rendin e ditës diskutuan: Sami Hamiti, Shemsi Veseli, Shpend Ahmeti, kryetar, dhe Sylejman Pireva, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Me propozimin që në rend dite të futet edhe Plani i punës së Kuvendit të Komunës së Prishtinës për vitin 2016, kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua ky

R E N D I I D I T Ë S:

- 1. Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve të mbledhjes së dytë dhe mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës;**
- 2. Raporti përfundimtar buxhetor për vitin 2015;**
- 3. Propozimvendimi për bartjen e buxhetit të pashpenzuar nga viti 2015 në vitin 2016;**
- 4. Raporti tremujor buxhetor janar – mars 2016;**
- 5. Shqyrtimi i Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës së Prishtinës për vitin 2016;**
- 6. Pyetje dhe përgjigje;**
- 7. Të ndryshme.**

Pika e parë

Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve të mbledhjes së dytë dhe mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të komunës.

Kryesuesi konstatoi se me 35 (tridhjetë e pesë) vota për, 4 (katër) abstenime (Ylli Hoxha, Imer Rusinovci, Lirak Çelaj dhe Shaip Shabani), u miratuan ekstraktet e procesverbaleve të mbledhjes së dytë dhe mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës.

Pika e dytë

Raporti përfundimtar buxhetor për vitin 2015.

Lidhur me Raportin përfundimtar buxhetor për vitin 2015 diskutuan: Sami Hamiti, Qëndron Kastrati, Muhamet Selmani, Mirlinda Sopi, Imer Rusinovci, Feti Mehdiu, Abetare Fazliu, Shpend Ahmeti, kryetar, Ylli Hoxha, Shefki Gashi, Lirak Çelaj, Sadri Ramabaja, Kreshnik Ahmeti, Agim Gashi, Sokol Krasniqi, Sylejman Pireva, Shemsi Veseli, Shiqeri Spahiu dhe Hatixhe Hoxha - Pupovci, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesuesi konstatoi se me 18 (tetëmbëdhjetë) vota për, 16 (gjashtëmbëdhjetë) kundër (Agim Gashi, Ajnishahe Azemi, Besa Rafuna, Flamur Shala, Halim Halimi, Hasime Krasniqi, Hazir Borovci, Laura Zherka, Lirak Çelaj, Lirie Avdiu, Naime Osmani, Sami Hamiti, Shaip Hajrizi, Shefki Gashi, Shemsi Veseli dhe Shiqeri Spahiu) dhe 2 (dy) abstenime (Muhamet Nura dhe Muhamet Selmani), u miratua Raporti përfundimtar buxhetor për vitin 2015.

Pika e tretë

Bartja e buxhetit të pashpenzuar nga viti 2015 në vitin 2016.

Për bartjen e buxhetit të pa shpenzuar nga viti 2015 në vitin 2016, diskutuan: Agim Gashi, Qëndron Kastrati, Mirlinda Sopi, Imer Rusinovci, Abetare Fazliu, Feti Mehdiu, Muhamet Selmani, Remzi Pacolli, Shefki Gashi, Hysen Durmishi, drejtor i Drejtorisë së Infrastrukturës Lokale, Kreshnik Ahmeti, Qëndron Kastrati, Lirak Çelaj, Sadri Ramabaja, Hatixhe Latifi-Pupovci, Hatixhe Hoxha, Laura Zherka, Ismail Kokaj, drejtor i Drejtorisë së Financave, Sami Hamiti, Sofije Bunjaku dhe Brahim Mehmetaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Shemsi Veseli propozoi që ndërmarrjes publike lokale "Sport-Marketing", t'i ndahet një shumë e mjeteve prej 85.000 euro, si ndihmë për mbulimin e shpenzimeve që kanë dalë nga renovimi i pishinës.

Lirak Çelaj, tha se çështjen rreth ndihmës në mjete financiare për ndërmarrjen "Sport-Marketing" e kam ngritë në Komitetin për Politikë dhe Financa, ku nuk ishte kundër asnjëri nga anëtarët e komitetit, andaj kërkoj që ky propozim të qitet në votim.

Hatixhe Hoxha u shpreh kundër votimit për ndihmë ndërmarrjes "Sport-Marketing", duke thënë se neve nuk na është prezantuar asnjë dokument relevant që do ta arsyetonte çështjen e votimit.

Kryesuesi konstatoi se me 20 (njëzet) vota për, 8 (tetë) kundër (Abetare Fazliu, Brahim Mehmetaj, Hatixhe Latifi Pupovci, Mirlinda Sopi, Nenad Miladinoviqi, Sami Boroci, Sofije Bunjaku dhe Ylli Hoxha) dhe 5 (pesë) abstenime (Genc Sherifi, Hatixhe Hoxha, Sadri Ramabaja, Sylejman Pireva dhe Teuta Krasniqi), u miratua vendimi për bartjen e buxhetit të pashpenzuar nga viti 2015 në vitin 2016 dhe përkrahjen për ndihmë në shumën prej 85 000 euro ndërmarrjes publike lokale "Sport-Marketing".

Pika e katërt

Raporti tremujor buxhetor janar-mars 2016.

Lidhur me Raportin tremujor buxhetor janar - mars 2016, diskutuan: Lirak Çelaj, Sami Hamiti, Brahim Mehmetaj, Qëndron Kastrati, Kreshnik Ahmet, Ismail Kokaj, drejtor i Drejtorisë së Financave, Sami Hamiti, Sokol Krasniqi dhe Shemsi Veseli, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesuesi konstatoi se me 15 (pesëmbëdhjetë) vota për, 14 (katërbëdhjetë) kundër (Agim Gashi, Ajnishahe Azemi, Besa Rafuna, Flamur Shala, Halim Halimi,

Hazir Borovci, Laura Zherka, Muhamet Nura, Mustafë Krasniqi, Naime Osmani, Sami Hamiti, Shaip Hajrizi, Shefki Gashi dhe Shiqeri Spahiu) dhe 2 (dy) abstenime (Muhamet Selmani dhe Fadil Gashi), u miratua Raporti tremujor buxhetor janar-mars 2016.

Pika e pestë

Shqyrtimi i Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2016.

Kryesuesi konstatoi se me 23 (njëzet e tri) vota për, 2 (dy) kundër (Genc Sherifi dhe Muhamet Nura) dhe 5 (pesë) abstenime (Ylli Hoxha, Halim Halimi, Hatixhe Latifi-Pupovci, Sadri Ramabaja dhe Teuta Krasniqi), u miratua Plani vjetor i punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2016.

Pika e gjashtë

Pyetje dhe përgjigje.

Kreshnik Ahmeti, kërkoi të dijë se çka ka ndodhur me AKP-në për hapësirat që ajo ende i shfrytëzon, kur ne në këtë Kuvend e kemi votuar një vendim për lirim e tyre.

Për pyetjen e parashtruar nga z. Ahmeti, **Muhedin Nushi**, drejtor i Drejtorisë së Administratës, dha sqarime të nevojshme.

Fadil Gashi kërkoi nga kryesuesi që pika “Pyetje dhe përgjigje” të jetë në fillim të rendit të ditës.

Remzi Pacolli kërkoi të dijë se a ka përfunduar procesi i matjes së fizibilitetit në lagjen “Arbëria” dhe nëse ka përfunduar, çfarë konkluzionesh janë arritur për atë pjesë të terrenit nga kompania që e ka bërë matjen.

Imer Rusinovci kërkoi nga ekzekutivi që të vazhdohet segmenti i rrugës edhe për 2 (dy) km, prej fshatit Nishec, që do t’i lidhte fshatrat Kushevicë dhe Brainë.

Laura Zherka kërkoi nga kryesuesi që të sillet një vendim mbi strukturimin e gjithë ekzekutivit, pasi janë bërë disa ndryshime nëpër drejtori, e që ajo lidhet edhe me funksionimin e Komitetit për planifikim, urbanizëm dhe mbrojtje të mjedisit.

Për pyetjen e parashtruar nga znj. Zherka, **kryesuesi** dha sqarime të nevojshme.

Hatixhe Latifi-Pupovci kërkoi nga sekretaria e Kuvendit që ta bëjë ndarjen e pyetjeve prej procesverbalit dhe t’ua dërgojë të gjithë drejtorëve.

Për kërkesën e znj. Pupovci, **Muhedin Nushi**, drejtor i Drejtorisë së Administratës, dha sqarime të nevojshme.

Shaip Hajrizi kërkoi nga ekzekutivi, që për pyetjet të cilat parashtrohen nga anëtarët e Kuvendit, përgjigjet të kthehen me shkrim.

Brahim Mehmetaj kërkoi nga kryesuesi që pika “Pyetje dhe përgjigje” të jetë në fillim të rendit të ditës.

Për kërkesën e parashtruar nga z. Mehmetaj, **kryesuesi** dha sqarime të nevojshme.

Qëndron Kastrati sugjeroi që, së bashku anëtarët e Kuvendit, ta bëjnë një deklaratë dhe të kërkohet nga ekzekutivi, që tash e tutje përgjigjet të kthehen me shkrim.

Sylejman Pireva tha se nuk është hera e parë që po kërkojmë që pikat e rendit të ditës, “Të ndryshme” dhe “Pyetje përgjigje” të jenë të parat. Rregullorja e Komunës nuk është dogmë, mund të ndryshohet, andaj le të ndryshohet dhe të merret vendim, se me të vërtetë nuk ka kuptim për pyetjet që i bëjmë nuk dimë ku t’i drejtojmë. Dy pyetje i kam shtruar në mbledhjen e kaluar dhe kurrfarë përgjigje nuk kam marrë.

Kryesuesi, tha se në mbledhjen e ardhshme do ta fusim si pikë të rendit të ditës formimin e grupit punues për ndryshimin e Rregullores së punës së Kuvendit.

Muhedin Nushi sugjeroi që në rast të ndryshimit të Rregullores së punës të Kuvendit, grupi punues, i cili do ta bëjë hartimin e saj, ta parashoh vendin ku do të vendosen kameramanët, pasi që prezenca e tyre në atë formë po pengon mbarëvajtjen e punës së Kuvendit. Po ashtu, në këtë rregullore do të ishte më se e rregullt që të vendoset edhe sistemi i ri i votimit.

Pika e shtatë Të ndryshme.

Qëndron Kastrati ngriti një shqetësim rreth mbarëvajtjes së testit të maturës dhe testit të semimaturës. Lidhur me këtë shtoi se edhe pse është kjo përgjegjësi e nivelit qendror, përderisa stafi dhe punonjësit e nivelit lokal dhe Drejtoria e Arsimit janë përgjegjës në lidhje me mbarëvajtjen, konsideroj që drejtoresha apo kushdo qoftë, të na raportojë në lidhje me këto veprime dhe të ndërmerren masa që në të ardhmen mos të ndodhë diçka e tillë. Për këtë çështje do të ishte mirë që ndoshta edhe në mbledhjen e radhës të jetë si pikë e rendit të ditës mbarëvajtja e testit të maturës dhe të semimaturës.

Muhamet Selmani ngriti shqetësimin e tij, duke thënë se nga Qendra për rehabilitimin e nënës dhe fëmijës, e cila është e vendosur me zyrë në lagjen “Tophane”, kemi marrë një shkresë, ku thuhet: “Komuna ka kërkuar që të merret objekti i asaj qendre dhe të shfrytëzohet për nevoja të tjera”. Dëshiroi që kjo çështje të futet në rend të ditës dhe të

aprovohet kërkesa e kësaj qendre, në mënyrë që t'i lihet në shfrytëzim objekti së paku edhe për 10 vjetët e ardhshme.

Brahim Mehmetaj tha se kjo temë është e ndjeshme, andaj Komuna duhet ta përkrahë kërkesën e kësaj Qendre dhe se Komuna duhet hulumtuar në gjetjen e një lokacioni të ri të mundshëm, apo atë lokacion, sepse është një vend ku janë kryer disa projekte humanitare, është dhënë kontribut para luftës, por edhe në luftë.

AjnishaheAzemi tha se Qendrës për rehabilitimin e nënës dhe fëmijës duhet t'i bëhet një zgjidhje, sepse ka dhënë një kontribut shumë të madh për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës me nevoja të ndryshme. Besoj që kemi edhe anëtarë të pranishëm që kanë marrë shërbime, ose familjarët e tyre, gjatë kohës së luftës dhe pas luftës, por ende vazhdon të japë, andaj duhet t'i vazhdohet qëndrimi aty.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesuesi i Kuvendit
Halim Halimi, jur. i dipl.

Faqe 6 nga 6